

VENDIM
Nr.784, datë 4.6.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, TË DATËS 23.10.2007, PËR ÇËSHTJEN “GJONBOÇARI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit 1 të nenit 46 të konventës europiane “Për të drejtat e njeriut”, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 8 e 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 23.10.2007, për çështjen nr.10508/02 “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 49 000 (dyzet e nëntë mijë) euro.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 20 qershor 2008.

3. Shuma prej 49 000 (dyzet e nëntë mijë) eurosh të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve “Gjonboçari dhe të tjerë”, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën kur do të çelet llogaria.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesve “Gjonboçari dhe të tjerë”, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha